



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____._____.2018

Lënda: Propozim i sistemit të vlerësimit të dosjeve të kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të plotë në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë,
Prof.Dr. Albert Qarri

I nderuar Z. Dekan!

Bazuar në përcjelljen e shkrësës me nr 1315/5 Prot, datë 19.11.2018 nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë me nr 269.Prot., datë 19.11.2018, bazuar në urdhrin me nr. 102 datë 19.11.2018 " Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të plotë, në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë për vitin akademik 2018 -2019", të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 64 "Punësimi i personelit akademik", pika 1, bazuar në mbledhjen e datës 20.11.2018 me këtë temë në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit si dhe në shkresën e zbardhjes së mbledhjes më nr 246/16 Prot., datë 20.11.2018, Ju përcjell propozimin për sistemin e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve si më poshtë vijon:

Në fazën e parë bëhet vlerësimi me pikë duke ju referuar rezultateve të shkollimit për çdo diplomë që zoteron kandidati, eksperiencës në mësimdhënie, aktivitetit shkencor, studimeve të ciklit të tretë, gradës shkencore dhe titujve akademikë si më poshtë:

Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në IAL në Shqipëri:

- Për diplomën "Bachelor" 0,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9 -10.
- Për diplomën "4-vjeçare" 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën "5-vjeçare" 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën "Master i Shkencave" apo "Master i Nivelit të Dytë" 0.5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.

1. Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë të fituar në universitetet perëndimore:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT

- Për diplomën “Bachelor” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
 - Për diplomën “4-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
 - Për diplomën “5-vjeçare” 1,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
 - Për diplomën “Master i Shkencave” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
2. Eksperienca në mësimdhënie në IAL në Shqipëri:
- Me kohë të plotë 1 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 5 pikë në total.
 - Me kohë të pjesshme 0,5 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 2 pikë në total.
3. Aktiviteti shkencor:
- Botime në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti 5 pikë çdo artikull.
 - Botime në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial 2 pikë çdo artikull.
4. Grada Shkencore dhe tituj akademikë:
- Doktor i Shkencave 50 pikë.
 - PhD në universitetet perëndimore apo Profesor i Asociuar 70 pikë.
 - Profesor i Asociuar 100 pikë,
 - Profesor Doktor 150 pikë
6. Komisionet ad-hoc janë përgjegjëse për respektimin e kriterëve dhe për procedurën e konkurimit. Këto komisione në çdo rast kanë të drejtë të kërkojnë dokumentacion shtesë për vërtetësinë e dosjes dhe të deklarimeve.
7. Në fazën e dytë, bëhet vlerësimi me pikë duke iu referuar intervistës me gojë e cila vlerësohet në intervalin nga 1-10 pikë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TE FINANCËS DHE KONTABILITETIT
Prof.AsDr. Filloreta Madani

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje